



Npi – 01/229 datë: 27.06.2025

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores së Punës të Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/155 të datës 27.04.2023, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më 27.06.2025, është nxjerrë:

E K S T R A K T P R O C E S V E R B A L

I Mbledhjes së -VI- të rregullt, të Kuvendit të Komunës së Shtimes,
e mbajtur më datën 27.06.2025 (e premte), në ora 8:00h, në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili, pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, anëtarët e Kuvendit: z.Besnik Seferi, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Veliu, z.Gëzim Haxhiu, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj, z.Artan Lubovci, z.Rrahman Jakupi, z.Lumni Amrushi, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Hasan Avdyli, znj.Albana Podvorica, znj.Adelina Beqaj, z.Rexhep Gashi dhe z.Reshat Mujota.

Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Drejtorat, Grejtalb Emini – DPUKGJ, Bardhyl Rushiti – DSHP, Besnik Ahmeti – DBF, Mimoza Salihu-Qeriqi, Nga Zyra për Informim, znj.Vlora Hyseni; Asistentja e Kryesuesit znj.Gentiana Mehmeti.

Për këtë seancë kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 29.05.2025,
2. Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028, (Pas diskutimit publik)
3. Pyetje – Përgjigje.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Rexhep Gashi: Përshëndetje. Ftesën e mbledhjes së gjashtë e kemi marrë me kohë, por mbi të gjitha në këtë rend të ditës i kemi siç e ceke më herë, t tri pika të rendit të ditës. Unë rendin e ditës do ta votoj se është obligim ligjor por mbi të gjitha e ngris si shqetësim, rreth planit të punës dhe mbledhjes ku thotë se në këtë mbledhje do ti kemi 5 pika të rendit të ditës, rishikimi i bugjetit për vitin 2025 nuk e kemi si pikë të rendit të ditës, e kemi shqyrtimi raportit të auditorit të përgjithshëm në vitin 2024 dhe informat e përgjithshme nga Drejtoria për Inovacion, a kemi drejtor në këtë drejtori se po më duhet me ta përsërit, pyetjen, e ki informat jo nuk kemi. Mbi të gjitha sot na ka ardhur një material vetëm mbi shqyrtimin e Ekstrakt Procesverbalit të mbledhjes së kaluar, Korniza Afatmesme Buxhetore dhe Pyetje - Përgjigje që mund të them vetëm është një pikë formale, të gjitha pyetjet që i kanë ngritur asambleistët në mbledhjen e kaluar nuk i kemi marrur as 10 përqindshin e përgjigjeve me shkrim, ju e dini se asambleistët nuk bajnë pyetje vetëm ashtu, por i ngrisin nga kërkesat e qytetarëve.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Sa i përket rendit të ditës deshta me u ndërlidh pak me zotri Gashin, ne para se të fillojmë me i marrë pikat për mbledhje komunikojmë me të gjitha drejtorit dhe i diskutojmë çështjet në zyrën e Kryetarit, se cilat pika do të futen në rendin e ditës, për disa nga pikat siç e tha edhe drejtori nuk ka material, dhe s'ka pse të jenë në rendin e ditës, ndërsa për disa pika e kemi pa të arsyeshme me i futë në mbledhjen e Korrikut për arsye se mbledhjen e mbajmë në javën e parë të Korrikut, kjo për arsye se pastaj Kuvendi shkon në pushim të verës, kështu që

pikat të cilat janë në Plan të Punës do të futen në muajin Korrik, përndryshe për tjerat pika drejtoritë vendosin vetë se sa do i binë si pika, ne e bëjmë ftesë, n vinë pikat i fusim në rendin e diës ato që nuk vinë, s'kemi qka me ju bërë.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 13 vota "Për", me 0 vota "Kundër", dhe me 6 vota "Abstenim", miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 27.06.2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 17 vota "Për", me 0 vota "Kundër", dhe me 2 vota "Abstenim", miratoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 27.06.2025.**

Pika 2

Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028, (Pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Para se të hapi diskutimin për këtë pikë, po sqaroj se dëgjimet publike janë mbajtur në secilin fshat dhe në secilën lagje urbane. Më vjen mirë që ç'do vit më shumë qytetar po marrin pjesë në dëgjimet publike dhe po na ndihmojnë që ta bëjmë Draft - Kornizën Afat Mesme Buxhetore në mënyrën më të mirë të mundshme. E di që materiali ka ardhur disa ditë me vones por ka pas arsye për shak të dëgjimeve publike, deri sa kanë përfunduar të gjitha dhe pastaj është dashur që kërkesat e qytetarëve çka kanë qenë më prioritare të futen në këtë Draft-Korniz. Po besoj që të gjithë keni arritur me parë materialin dhe një çështje tjetër është që në Komitetin për Politik dhe Financa dhe në Komitetin për Komunitete, të dyja këto Komitete rekomandojnë me shumicë votash që të kaloj kjo Draft-Kornizë Afat Mesme Buxhetore për vitin 2026-2028.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Përshëndetje. Më lejoni të ju njoftoj se kjo Draft-Kornizë ka rrjedh si rezultat i diskutimeve publike në të gjitha vendbanimet e Komunës së Shtimes dhe në përfundim buxheti prej 11 milion e 443 mijë euro është buxhet që ka ardhur përmes vetfinancimit grantit të përgjithshëm (shih dokumentin), granti për arsim (shih dokoumentin) granti për shëndetsi, shërbimet dhe të hyrat vetanake (shih dokumentin). Pas diskutimeve publike në të gjitha fshatrat e Komunës së Shtimes, Drejtoria e Financave në bashkëpunim me gjitha drejtoritë janë ardhur në përfundim që buxheti të ndahet në katër kategori ekonomike. Paga dhe medijtje etj. (shih dokumentin). Sa i përket numrit të stafit për vitin 2026 janë 748. Dhe për 10 është numri më i madh se këtë vit për shkak të disa politikave të reja, 6 janë staf që kanë me u destinuar te Çerdhja në Petrovë, ndërsa 4 është numri në shëndetësi ku janë paraparë për mjekësinë primare, pra është një psikolog, një fizioterapeut një logoped edhe një punëtor social. Kjo është një politikë e re nëpër të gjitha komunat e Kosovës, faktikisht 192 pozita të reja, ku komuna jonë i ka 4 pozita. Marrë për bazë dëgjimet publike duhet me i shiquar cilat projekte janë duke vazhduar ose janë të buxhetume më herët me kornizën e më hershme buxhetore. Po ashtu gjitha kërkesat që kanë rrjedhur pas diskutimeve publike na i kemi marrë ato kërkesa çka kanë qenë më prioritare dhe kanë hy në buxhetin për vitin 2026, një pjesë e tyre ka mbet me u realizuar këtë vit, e të cilat kanë qenë kërkesa të përsëritura dhe një pjesë e kërkesave që kanë një kosto më të madhe, priten me hy me buxhetin e Ministrisë në nivelin qendror. Në përgjithsi kjo është e tëra për këtë dokument pres nga ju që të miratohet ky dokument. Komuna Shtimes e ka kalendarin për 2 Korrik me i mbrojtur kufijt te departamenti i buxhetit në Ministrinë e Financave, këtu mbrohen vetëm kategorit ekonomike, mirëpo lëvizje brenda projekteve kapitale mund të ketë deri të aprovohet buxheti, ju ftoj ta miratoni këtë Korniz Buxhetore.

znj.Rrezartë Ramadani: Përshëndetje, unë kam disa kërkesa që kanë ardhur nga qytetarët: Kërkesa e parë është që të ndërtohet një rrugë tek aneksi i rrugës "Komandant Kumanova" mbrapa "Maksiti Putz" pasi që janë gjashtë shtëpi që nuk kanë rrugë, gjithashtu te Lagja Neziraj në Mollopolc kërkohet që të përfshihet edhe ndriçimi, e pash që në buxhet është trotuari por jo edhe ndriçimi, kështu që kërkoj që të përfshihet edhe ndriçimi. Gjithashtu e pash një shumë të madhe 130 mijë euro për vitin 2026 ndërsa për 2027 parashihet 418.100.20 euro dhe në vitin 2028 është 235 mijë euro, shumë totale rreth 784 mijë euro që parashihet për këto tri vite të jenë të ndara për

projekte me Ministrinë si dhe me Organizata të ndryshme, mirëpo nuk ka asnjë specifikim se ku do të shkojnë këto të holla dhe kërkoj në Shtator kur të vije për buxhet të bëhet specifikimi, sepse është një shumë e madhe. Gjithashtu shpresoj që deri në Shtator, se ka projekte ndër vite që i kemi shti si LDK mirëpo këto projekte kanë mbetur vetëm në letër. Kërkojmë që këto projekte deri në Shtator të realizohen për ndryshe nuk kemi votë, sepse nuk lejojmë që projektet të mbesin vetëm në letër.

z.Reshat Mujota: Përshëndetje. Sot kemi para vete Kornizën Buxhetore 2026 -2028 të cilin draft e kamë shikuar kogja me kujdes si para dëgjimit publik edhe pas dëgjimit publik. Mirë kishte me qenë procesverbalet e dëgjimeve publike me i pas ç'do asambleist sot në mbledhje. Sa i përket Draftit dhe kërkesave të qytetarëve po nisna në atë pjesën ku kamë qenë pjesëmarrës, edhe unë kërkesat që i kanë bërë qytetarët i kamë njëjt si para dëgjimit si pas dëgjimit publik, ju ka ndrru vendi, kolona por as nuk ju ka ndrruar vlera as nuk ju ka ndërruar kërkesa e projekteve.

Po nisna nga fshati nga i cili vi unë ka qenë kërkesë shtesë se këto na i kanë bartë qe tri vite prej vitit në vit, kemi diskutuar për këtë edhe në dëgjim publik, tani na kanë dalë për vitin 2026, ndërsa shuma te pjesët e projekteve, e mjeteve nuk ka ndryshuar aspak. Shkojmë te kolona 14 me kod 56 221 ku thuhet rregullimi i trotuarve dhe asfaltimi i rrugëve në Mollopolc te ujvara, trotuar te rruga Neziraj, kanalizim te Kulla mjetet financiare janë 60 mijë euro, ndërsa në teren nëse dalum vetëm rruga ose nëse jan rrugica me 60 mijë euro, duhet të jenë të specifikuara cilat rrugë. Kërkesa ka qenë te rruga "Islam Neziraj" që të riparohet aty pjesa me asfalt sepse është dëmtuar shumë, dhe shumën e kemi 60 mijë euro. Nëse funksionalizohet për vitin 2026 dhe ipet si projekt dhe shtrohet ajo rrugë, vetëm rruga do ti merrë shumën e 60 mijë eurove, ndërsa sa i përket projekteve tjera, trotuar, kanalizim te Kulla unë nuk e besoj që mund të përfshihen gjitha këto punime. Ka qenë kërkes ku je kanë prezent edhe ti Kryesues dhe drejtori i Urbanizmit që të jetë edhe oborri i Kullës, ndërsa këtu nuk ka ndryshuar aspak. Te pjesa e parqeve e njehta shumë prap është që do me thënë as pas dëgjimit publik, te kolona 2 ndërtimi parqeve në qytet e fshatra Gllavicë, Mollopolc, Petrovë, Pejtërshticë, Carralevë, Reçak, Godanc i Poshtëm, Lagje e Pajtimit, 139 mijë e 987 euro me kod 56 080. Nëse i marrim dy kornizat, na edhe para dëgjimit publik edhe pas dëgjimit publik na jesin vlerat edhe kërkesat e njehta, dmth. a u majt dëgjimi publik, a pat kërkesa të qytetarëve a u përfshin në draft pas dëgjimit publik. Në qito dy kolona asnjë kërkesë shtesë nuk e kemi, dhe jo vetëm në këto dyja po në shumë kolona janë të njejtat që nuk janë përfshirë kërkesat e qytetarëve, ato më primare që janë. Nëse flitet për parqe atherë në fshatin Mollopolc vitin e kaluar edhe para dy vite është premtuar një park në mesin e fshatit, ku ne e kemi edhe parkun te sheshi i flamurit që don renovim patjetër, aty duhet me intervenuar. Kemi parkun "Skender Salihaj" që aty besoj që ç'do njeri i banë nder që e mban emrin e dëshmorit "Skender Salihaj" asnjë rregullim, asnjë intervenim, asnjë mirëmbajtje, ku vet familja me mjete vetanake e mirmabjnë atë park. Kam pas kërkesë s'di sa herë në këtë Kuvend që me punu, dhe aty të ndërtohet ai park për 3 vjet e gjysëm, mandat nuk i keni këto kërkesa të kryera të cilin me qeverisjen tuaj unë nuk i kamë përjetuar në fshatin tim, dhe nëpër shumë fshatra tjera kërkesat e qytetarëve. Me pas ardhur procesverbalet e kërkesave të qytetarëve në dëgjime publike e kishim pas shumë më lehtë dhe diskutimi kish me qenë shumë ma i qartë, konkret që këta me pa a janë përfshirë kërkesat e qytetarëve. Me këto bartje të mjeteve dhe kërkesave të cilat nuk janë realizuar nëpër kolona edhe nëpër kode buxhetore me keqardhje e thamë unë këtë Draft Korniz nuk mund ta mbështesë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Para se me kaluar te dikush tjetër veq një informacion sa i përket dëgjimeve publike dhe procesverbalit, shumë thjeshtë e keni me pa vetëm futuni në ueb faqen e Komunës që nga dita e hënë të publikune i keni dhe i keni të gjitha kërkesat për secilin fshat që janë bërë nga qytetarët, e di që se keni kopjen fizike por e keni më lehtë me pa në ueb-faqe te Komunës, çdo gjë është transparente.

z.Kadri Emini: Përshëndetje, sot para vetës kemi Kornizën Afatmesme Buxhetore një dokument jashtëzakonisht i rëndësishëm për votim. Ne jemi të vetëdijshëm dhe jemi të informuar edhe përmes rrjeteve sociale që debatet publike janë mbajtur në secilin fshat e secilin lokalitet në Komunë. Ajo çka du me ngrit unë si shqetësim e që në vazhdimësi i kamë rekomanduar edhe Kryesuesit edhe Drejtorisë përkatëse, që janë mbajtur debatet publike që e rëndësishme është që

pjesmarrja e qytetarëve me qenë në nivelin sa ma të mirë të mundshëm. Në rastin konkret kjo Kornizë Afatmesme Buxhetore është mbajtur me një njoftim për debat publik në faqe të Komunës edhe absolut kurgja ma shumë. Ju e dini që na aktualisht, kryesit e fshatrave i kemi valide për deri sa nuk kemi arrit me i zgjedhë të tjerët, pse mos me u njoftu personalisht ata, sinqerisht mendoj që është jashtzakonishtë shqetësuese mos me u njoftu kryesia e fshatit, Kryetari i fshatit për një debat publik, kur e dimë që është dokument i rëndësishëm, sepse kemi të bëjmë me ndarje të buxhetit që buron direkt nga qytetarët dhe nevojat e tyre. Kryetari dhe kryesia e fshatit i dinë më mirë se një qytetar i fshatit prioritete me një lagje me një fshat unë sinqerisht shumë herë kamë dhënë rekomandim, njoftoni lagjet njoftoni kryetaret e fshatrave. Marr parasysh edhe shqetsimet qe edhe kolegja Rrezartë i tha. Unë personalisht kamë edhe propozime konkrete por në këtë faz nuk du me i paraqitur, aktualisht na jemi abstenim sa i përket KAB-it.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Faqja e komunes së Shtimes e bënë publikimin për KAB zotri Emini për dëgjimet publike dhe që nga dita që ne e vootjmë më shkuar në dëgjim publik, ajo është senacë live lku shihet edhe e shohin të gjithë qytetarët dhe me mijëra qytetarë e përcjellin senacën, pastaj bahet publikimi për komplet datat, në këtë rast ka ndodh dy jav ditë dëgjimi publik, pastaj është bërë cdo ditë për secilin fshat e lagje publikimi dhe realisht në disa fshatra kanë qen Kryetaret e fshatrave kan marer pjes disa fshatra nuk kan mmarr pjes ka qene dhe orari sinqerisht ka mnumer mat madh të pjesmarrjes. Pajtohem me atë pjes që trhu duhet mi thirr edhe persoanlisht Kryetaret e fshatrave por nuk është që nulk ka pas kërkesa të jeni të bindur me 2.5 milion investime kapitale nuk mundesh mi mbuluar, ka edhe kontrat aktive me ministrit që po mundohet komuna shtimes mi realizuar kërkesat e qytetarëve, por ka fshat që e thash që i ka 30 kërkesa është e pa mundur mi inkorporu krejt ne këtë Draft Kornizë e më një fshat tjetër me lan fare pa e përfshirë në bugjet. Ju e dini se bugjeti ndahet nga pozita gjeografike edhe nga kok banori , dhe e dini edhe ju jeni te vetdishum se është kaluar investimi ta zam një fsht psh që i ka pasur 100 mijë euro investime për vitin 2024 dhe 2025 ju e dini që jan tejkualuar, jo 100 mijë por ndoshta ka shkuar edhe 1 milion euro investimi ne do ti marrim mgjitha kërkesat prioritare por jo gjitha që mundem me u futur ne këtë kornizë.

znj.Adelina Beqaj: Përsëndetje, si draft për mua po më duket që është i zbeht, për arsye se nuk keni pasur projekte konkrete madhore për ndonje fshat të caktuar ndonje vendbanim të caktuar, mirëpo jeni munduar me i lidhë disa fshatra me disa rrugë të nevojshme por jo shumë të arsyeshme sa i përket draftit bugjetor, e marr për shembull Muzeqina me Rashincën e kanë psh. një rrug që i lidh këto fshatra asnjë projekt konkret në këto fshatra nuk keni që duhet me u mburr banorët, është një rrug që i lidh këto dy fshatra asgjë më shumë rreth këtyre fshatrave. Rruga “Mehdi Korrani” se di ka dal, trotuari aty menxi e keni bërë një rrugë ku doni me qit trotuarin. Kamë edhe propozime konkrete për heqjen e shkollës së vjetër në fshatin Belinc për arsye se është demoluar shumë kjo shkollë dhe është mbush me bari e me therra, kërkesa është që të bahet park. Te rrethi në fshatin Belinc me ba një kërkes në Ministri që të bëhet një rregull aty afër sepse ëshë rreziku është i madh, trotuaret në Petrovë nuk po mirmbahen, ka asambleista që po mburren me këto investime, i keni kontrata, keni kompanit për mirëmbajtje, çka po ndodh në këtë pjesë.

z.Gëzim Haxhiu: Përsëndetje. E kamë një kërkesë shtesë e cila ka të bëjë me fshatin Rashincë konkretisht për rivitalizimin e rrugës që e lidhë fshatin Rashincë me fshatin Gllavicë.

z.Rexhep Gashi: Me të vërtet e kemi një pikë të ndieshme, ju falimiderojm legjislativin që kan marrë pjesë nëper dëgjime publike, e dimë që është interes i qytetarve edhe drejtorat kanë qenë edhe gjaët fotove kanë qenë prenzent edhe janë munduar me i elaboruar gjitha projektet te lista e propozimeve te investimet kapitale, thanë shumë pak ka ndryshime, kërkesat janë shumë të mëdha, disa kërkojnë projekte ma me prioritet, mbi të gjitha ne, ky buxhet te fshatrat ti kapim projektet ku janë ma me prioritet, te kanalizimi dhe te ujësjellësi ka shumë pak që mundemi me i bërë zgjidhje qytetarëve. Kam ngrit si shqetësim te shumat e projekteve, kemi 9 projekte me një shumë të vogël çka mundemi me bërë, kemi projekte me 10 mijë euro, cilin projekt mundemi me kry me kaq pak, kemi projekte të cilat mund ti lexoj, (shih dokumentin) duke pas parasysh terenin çka mundemi me bërë me 10 mij euro lexoi Draftin (shih dokumnetin). Cili projekt zotohet, cila drejtori e kryn me 1100 euro (shih dokumentin Draftin), ka projekte në Karqicë, Dugë me 5000 euro çka mundemi me bërë, rregullimi i kanalizimit në Mollopolc, rregullimi i oborrit të kullës,

rregullimi i ndriqimit në lagjen Neziraj me 10000 euro. Unë mendoj se duhet të ishim shumë të kujdesshëm rreth projekteve, dhe qysh i kamë ngritur shqetësimet se këto projekte disa, se nuk po thamë unë se mundem me dështuar të gjitha, po me 5 mijë euro 9 projekte janë të dështune, janë në letër, qysh ka dështuar ujsjellsi i Pjetërshticës në legjislaturat e kalume me qu ujin prej Carraleve në Pejtershticë qashtu, edhe këto disa dështojnë. Ju lutem për Pjetërshticë ka qenë zotim i juaji që do të zgjidhet problemi i ujësjellësit, jeni zotuar se kanalizimet në gjitha fshatrat do të përfundojnë, nuk keni mundur ti prekni krejt. Nuk jamë këtu për kritik por jamë për të treguar se me të vërtetë nuk keni mundur ti mbani ti zotoni. Te kjo lista e projekteve e dimë se sot duhet me kaluar, por mbi të gjitha ka hapsirë për me u korrigjuar dhe aty ku janë 9 projekte me 5000 mijë euro dhe aty ku janë 11 projekte me 10000 euro, ju lutem nuk është kurgja të mirremi me qytetarët me ju thanë këto i kemi bërë vetëm për fushat se 11 projekte veq mi numruar janë shumë se leje me u realizuar, kjo është realiteti. Nëse në Gjyrvoc është realizuar një projekt, ka qenë vetëm një kërkesë e banorëve të Gjyrvocit, thujum nëse është realizuar ajo publikisht thuje. Asnjë prej juve smuni me thënë që është prekur fusha e sportit aty.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Ju lus drejtor që mos të ju ndërhyri asambleistëve, mbani shënime por mos ju ndërhyri.

z.Muhamet Ademaj: Përshëndetje. E falënderoj drejtorin për financa zotri Besnik Ahmetin për prezantimin e Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitin 2026-2028. KAB-i është vetëm një udhëzues që i paraprin votimit të buxhetit nuk është kornizë përfundimtare, është kornizë orjentuese e cila në Shtator do të orjentohej edhe investimet kapitale. KAB-i ka qenë në diskutim publik edhe unë kamë marrë pejsë në dëgjim publik në fshatin Petrovë. Unë si anëtar i Kuvendit për KAB-in kamë këto kërkesa propozime: Ndërtimin e rrugës që lidh rrugën “Kruja” me rrugën “Mehdi Korrani” me gjatësi 1500 metra, ujësjellësin për shkollën “Bajram Curri”, ndoshta u ba e tepërt kjo që një shkollë me 500 nxanësë gati që tetë vite mos me pas ujë të pishum, edhe mos me i dhanë prioritet e me zgjidh këtë problem po më duket jo e mirë, asfaltimi i rrugës në segmentin e rrugës “Hyrë Emini” me gjatësi 200 metra, asfaltimi i rrugës në segmentin e rrugës “Kruja” me gjatësi 300 metra, edhe e kemi ndriçimin në lagjen e Robojve, ka lagje që 25 vite nuk është investuar asnjë cent si kjo lagja e Robojve ku në këtë lagje mungojnë edhe kanalizimi edhe ndriçimi. Deri sa nuk mirren për bazë këto kërkesat e mia edhe kërkesat e shumë qytetarëve që janë të pa kënaqur që nuk po ju mirren për bazë kërkesat e tyre unë do të votojë kundër.

z.Besnik Seferi: Përshëndetje. Sot jemi mbledhur këtu për me diskutuar një dokument ma të rëndësishëm që është Draft Korniza Afatmesme Buxhetore 2026 – 2028 një plan që ka për ti orjentuar qartazi prioritetet zhvillimore financiare dhe politikat tona në të ardhmen e afërt. Përgaditja e kësaj Kornize, dua të ju them gjithë kolegve, nuk ka qenë e lehtë aspak për faktin se kemi takuar shumë qytetarë ku kamë qenë edhe unë bashkë me drejtorët dhe me Kryesuesin, njashu edhe me Kryetarin zotri Aliu. Këto takime i kemi bërë në mënyrën ma të mirë të mundshme. U diskutuar qështja e informimit të duhur kjo nuk ekziston si shqetsim, sepse te paktën pikërisht këta këshilltar komunal kanë qenë në dijeni të këtyre takimeve të dëgjimit publik ku e kanë ditur edhe ditën edhe orën e sakt se ku do të mbahet. Dua të them edhe diçka, nuk po më vije për qudi, për faktin që sot edhe nga pozita e koalicionit tonë AKR-LDK paskemi abstenim e kundër, votë kjo ndoshta është paksa e ditur. Mua më vjen keq që opozita asnjëherë në Kuvend nuk ka qenë në përkrahje të këtyre projekteve zhvillimore pavarësisht që janë në interes të qytetarëve, madje janë bojkotuar edhe projekte madhore për të cilat qytetarët kanë shprehur gëzim dhe mirënjohje për vendimarrjen tonë si pozitë, të tilla janë disa projekte infrastrukturore që sot janë duke u jetësuar në lagje dhe fshatra, ku për vite të tëra kanë qenë të lëna pas dore. Dua të potencoj që ç’do projekt që është kryer dhe ç’do projekt që do të kryhet do të ketë ndikim në jetën e qytetarëve të komunës së Shtimes. Jemi në muajin e fundit elektoral dhe gjithë kandidatëve ju uroj suksese dhe shëndet e suksesin sigurisht kanë për ta përcaktuar qytetarët e komunës së Shtimes me 12 tetor të po këti viti. Është e kuptueshme që ç’do punë e mirë e pozitës nuk është që ka për ti pëlqyer opozitës, se dihet mirë që kjo është politik. Këta muaj është mirë që mos të bëhet politikë aq më pak nga koalicioni jonë që kemi rrugëtuar deri më sot AKR dhe LDK.

z.Asllan Beqaj: Po du me u ndërlidh pak shkurtimisht të çështja e njoftimit për degjimet publike, besoj që njoftimi ka qenë shumë në rregull. Në fshatin ku kamë marrë pjesë edhe unë në dëgjim

publik ka qenë edhe Kryetari i fshatit edhe kryesia edhe ka pasur edhe banor nga gjitha lagjet e fshatit. Tash pajtohna me kolegün që foli pak përpara, nuk më vije çudi prej opozitës, por po më vjen çudi prej koalicionit sidmos prej AKR-së, me i pas drejtuar më herët këto kërkesa të qytetarëve besoj ishin realizuar, e jo me ardh një muaj pa parafunduar kjo legjislatur edhe me thanë që s'jan realizuar. Besoj që janë realizuar shumë projekte si rrugë, trotuare, ndriçim, kanalizim etj. duke pasur parasysh që buxheti është i limituar 2.5 për investime kapitale. Besoj janë bërë shumë punë të mira. Ka pas tri vjet me ba kërkesa. Ç'do kërkes që janë drejtuar te unë janë realizuar, besoj i kanë lanë anash kërkesat e qytetarëve dhe janë munduar me i shty përpara kërkesat personale.

znj.Adelina Beqaj: Deshta me u ndërlihdh me Bsnikun, është e vërtet që se kena votuar, sepse i kena parë defektet në mënyr profesionale dhe nuk më duket e logjikshme me votuar një buxhet të tillë. Qe tri vite keni shtrur do rrug të vogla nuk keni përfunduar projekte të mëdha, a din çka keni përfunduar ju Çerdhen në Muzeqinë që veq ka qenë themelet edhe Çerdhen e vjetër në Shtime, ajo Ministresha e juve e ka quajtur Çerdhe të re, a unë vet i kamë pasur femijët që kan mësuar prej viti 2019 deri sa kan dal në Çerdhen e re, e ju e keni quajtur Çerdhe të re. Këto janë kanë projektet ma madhore të juve që i keni bërë, ndërsa tani ja keni nis në kohë të fushatës me ba kishe diçka me qapuris pak nëpër fshatra, nuk muj me votuar kesi lloj buxheti më falni. Muj me analizuar që ka projekte konkrete e jo me votuar një buxhet që unë vitin e kaluar e kamë cekur, keni bërë ma shumë se 20 projekte me vlerë më shumë se 10 mijë euro, kjo është e pa logjikshme, kështu që nuk mundem me votuar une një diçka të tillë. Nëse ti Besnik si profesionist, që e kena fillu rrugën politike bashkë në këtë Kuvend mundesh me përkrahë një buxhet të tillë është përgjegjësia jote, por mos më akuzo në Kuvend për diçka që i kamë të qarta çka keni punuar, tani ja keni nisë sepse është vit i fushatës ja keni nis me kry punë sepse vet e keni në dorë.

znj.Zejnije Veliu: Përshëndetje. E falënderoj drejtorin Besnikun, nga ky material që na ka ardhur po e shofim se projektionet buxhetore është mbi 11 milion euro dhe i shpërndar në pesë kategori. Nga materiali që kemi marrë shifet një gjithpërfshirje në të gjitha lokalitetet në bazë të nevojave të qytetarëve duke ju dhënë prioritet kërkesave specifike të qytetarëve nga dëgjimet publike të cilat janë mbajtur në çdo cep të komunës së Shtimes. Nga ky draft vjen edhe nga kërkesat e qytetarëve dhe kur vije nga to shihet që kontribuojn në një buxhet më efikas dhe ka pasur suksese dhe ka pasur punë që janë kryer edhe po kryhen. Për veç kërkesave që kanë ardhur nga qytetarët kemi prioritet edhe kërkesat për mjeksinë primare sidomos në mjekësinë primare ku Shtëpia e Shëndetit në Shtime ka pasur nevojë për këto profesione e që janë paraparë me këtë buxhet. Mund të themi se këto punë që po kryhen në çdo cep të Shtimes, është shëndërruar në një vend punishte, pra këto punë që po kryhen janë dalë nga këto KAB-e që janë votuar më herët, kështu që ne kemi gjetur projekte që është dashur ti përfundojmë, mirëpo veq atyre kemi edhe projekte që janë edhe në qeverisjen Aliu, gjë që në çdo cep të Shtimes në çdo rrugë e vëren tu punuar makinerinë e rëndë dhe aty ku është makineria e rëndë shihet edhe që po punohet.

z.Rrahman Jakupi: Përshëndetje. Nuk desha me u kyqur për këtë diskutim, mirëpo kur po dëgjoj, opozita opozita, sa për informatën e juaj opozita s'ju ka borxh juve me ua votuar asnjë projekt, opozita e ka për obligim me mbikqyrë punën e ekzekutivit që po bëhet në Kuvend, ky është roli i opozitës, po mue më vjen keq që keni qëndruar gjatë në opozitë dhe prap do të ktheheni në opozitë edhe nuk keni arritur me kuptuar rolin e opozitës. Ne i gëzohemi gjitha projekteve që vinë në komunën e Shtimes, mirëpo me ua hjekë juve investimet e Qeverisë ju asnjë projekt kapital nuk e keni realizuar në Komunën e Shtimes, për veç kohëve të fundit që keni filluar duke i bërë disa asfalte të shtëpiave private, për të cilat besoj që do të ketë hetim, kemi pritur me i përfunduar gjitha, ndërsa qytetarëve që munden me marrë asfaltin i ftoj me shtruar asfalt, mirëpo do të ketë një hetim kogja të mirë për këtë çështje. Opozita nuk i ka votuar disa dokumente të juajat, disa Vendime për shkak se mungojnë dokumentet strategjike, por e di që këto nuk i kuptoni. Shumica e dokumenteve strategjike kanë skaduar madje edhe ky buxhet i cili është dashtë me u referuar në ato dokumente strategjike s'ka bazë se ku me u kapur. Gjitha projektet që realizohen nuk kanë ndonjë arsyeshmëri. Shumica e kolegëve si Adelina Reshati Rexha, të cilët përmendën që ato projekte sjanë projekte substanciale janë projekte me 5 mijë euro me 10 mijë euro, me një projekt 10 mijë euro i kanë, shti 7 a 8 projekte që veç me thanë që e kena shti

projektin, mirëpo realisht ai mandej nuk zhvillohet në teren. Janë tri çështje kryesore të këtijë buxheti që sot po diskutojmë që i mungojnë: baza ligjore, mungojnë dokumentet strategjike që kanë skaduar, projektet s'kan asyeshmëri dhe këto projekte nuk janë substanciale. Kuptohet gjitha projektet që vinë në komunën e Shtimes janë të mirseardhura, ne do ti monitorojmë ato projekte do ti analizojmë, madje disa projekte prej tyre ju e dini që vetë i keni ankesat me ka 250 ankesa me një projekt që e keni realizuar, kur ti bani projektet me njësi speciale mi fillu atherë nuk është tregues i mirë. Këto janë arsyt pse opozita, Partia Demokratike të cilën e përfaqësojë dhe kolegët e mi këtu që janë nuk kanë votuar disa dokumente duke marr parasysh që qidnra dokumente vet Misnistria e Pushtetit Lokal i ka kthi si dokumente të kundërligjshme. Tjetra sa ju përket investimeve të çështja e Arsimit e mirëmbajtjes, do shkolla që i kemi lanë të gatshme ju skeni arritur mi mirmbajtur për këto katër vite, madje madje nuk keni arritur edhe me toner me i furnizuar, ka qenë ky problem i vazhdueshëm deri sa operatorët ekonomik hynë edhe i shkulin printerët e llatopët është e dhimbshme, domethënë s'keni arritur as qato me i mirëmbajt e ju po më flisni sot për projekte të mëdhaja, buxheti fenomenal e sene. Mirë megjithate ne të kaloj ky dokument nga ana juaj, ne i kemi arsyt tona, shumica i thanë kolegët ne do të jemi kundër këtijë dokumenti i cili nuk i plotësonë fillimisht kushtet minimale themelore, bazike, për ta votuar.

znj.Rrezartë Ramadani: Unë deshta me i replikuar Besnikut, kur u ankove për kolegun nuk ke ankesa tina për dëgjime publike por ke për ftesë që nuk u është bërë Kryetarëve të fshatrave, dhe e dyta nëse ti e konsideron faktin që ne po kërkojmë që projektet të realizohen mos të mbesin në letër, në qoftëse ti po e konsideron politik ather kjo ma shumë fletë për ty, nëse ne kërkojmë projkte mos me mbet veç në letër nëse e shef ti poltikë këtë atherë politikë je tu u ba ti, po më vjen keq, na thjesht jemi tu pas dëshirë që këto projekte janë propozuar për qytetarët dhe ju kanë premtuar qytetarëve, kështu që politikë dihet kush po bënë.

z.Besnik Seferi: Ju e dini që deri në 2017 kemi qenë në opozitë na keni kritikuar pse spo jeni pjesë e dëgjimeve publike, tash ju nuk po merrni pjesë, e sa i përket koleges që tha po bënë politikë ke pas mundësin edhe ti kolege nëse ke pas interes të madh ke mundur mi shti kërkesat, kur po tham politik se duhet kogja një far analize e madhe me u bërë nëse sot na propozojmë projekte edhe sot parashtrojmë kërkesa për projekte, prandaj si të tillë edhe unë kamë plot kërkesa, besomni në zot që shumica prej tyre nuk më kan hyr fare hiç, kamë para shtëpis teme që duhet me u bërë por e kamë pa që të gjitha kërkesat duhet me u shtri në një far mundësiae që të ket gjithpërfshirje të të gjitha projekteve pa dallim, prandaj nuk ma hek kërkuh mendjen se sot në kët Korniz është duke u bërë puro politikë.

z.Muhamet Ademaj: E ceku emrin tem Asllani, unë bashk me Asllanin kemi qenë për interesat e qytetarëve për me pas projekte në fshatin Petrovë, mirëpo e ftoj Asllanin me ardhur në lagjen time, tash komuna që është duke i realizuar disa projekte, psh. asfaltimi nëpër oborre të lagjes dhe çfar dallimi banë psh. mes njerëzve ka banor që nuk banojnë hiç aty jan në botën e jashtme ju shtrohet asfalti, ndërsa njerzit që jetojnë aty nuk ju shtrohet asfalti. Asllan të ftoj me ardhur edhe vet me vërtetuar unë e kam propozuar edhe ka qen në buxhet shtrurja e rrugës aneks rrugës “Kruja” në 2023, u banën qe tri vjet ky projekt nuk realizohet, a në fakt aty shkruhet te financat që është kryer por në at segment asnjë asfalt nuk është kryer nuk e di se ku ka shkuar ai asfalt. Prandaj e kam parë që nuk është duke u punuar drejt, edhe këta drejtorat është mirë me ardhur me na pyetur neve edhe na me dhënë mendim, mirëpo kohën e fundit janë duke i shikuar vetëm interesat e tyre personale.

z.Asllan Beqaj: Po tu drejtova prof në lagjen e juaj, jena kan në përrurim të ndriçimit publik, jena kanë në përrurim të trotuarve, të rrugëve, kanalizimit edhe besoj publikisht ti e ke pranuar se në lagjen Ademaj u punuar ma shumë se komplet katër mandatet e tjera, këtë e ke thënë në prani të krejt banorëve, tani vjen mas tri vjet e gjys mandat edhe pe akuzon qeverisjen këtu po më duket jo korrekti prej teje edhe te koke tu kërku po më doket prap diçka ma herët qysh i ke pasur ato kërkesat e tua. Tjetra te kolegja që foli ma herët e kamë vetëm një pyetje pse s'po realizohen projektet qe tri vjet e gjysëm, herae parë që e drejton, kështu që kisha kërkuar korrekti prej juve me u bërë korrekt para banorëve, përpara qytetarëve të Shtimes e jo veç me i shikuar interesat e

juve personale. Me pas shikuar interesin publik shumica e projekteve në Lagjen Ademaj e në krejt Shtimen ishin kry deri tani.

z.Reshat Mujota: Ju kisha lut Besnikut me i ndëgjuar mirë qështjet sepse po ndërlikohen tani kërkesat se ku i kena bërë që sot nuk i kemi në KAB. I nderuari Kryesues unë po shof që tash është kohë fushate e kta po gjuhen me spunta koalicioni juaj që e keni pasur. Kërkesa për ujë të pijshëm për shkollën në Petrovë ka qenë çdo Korniz Afatmesme. Unë nuk do të flas për Petrovën shumë se ka kogja përfaqësues të Petrovës këtu, vet Kryesuesi është prej Petrovës, Asllani prej Petrovës, Adelina prej Petrovës, profa prej Petrovës. E kamë një lutje për këta, dy të fortit e Vetvendosjes Besnikun dhe Asllanin se këta u deklaruan gjitha kërkesat që janë adresuar te ta jan realizuar, unë kamë kërkes sdi sa herë qitu një kërkes për nxanësat e Mollopolcit, tej Besniku e ka kërkuar, ndërsa sot nuk bënë za për transportin e nxënësve në Mollopolc. Unë e kam pa që Besniku fol por voton kundra edhe fjalve të veta, qon doren edhe pa kërkesën e vetë që ka pasur a unë nuk mundem me i bërë këto. Ju të Vetvendosjes jeni dalë shumë mosmirnjohës ndaj koalicionit të juaj kur keni rrugtuar gjithë këto vite bashkë edhe interesat i keni quar përpara bashkë, tani mos ju gjuni as profes as Rrezes, se shihni një sfid. Po thuni mos bënë politik jeni ardhur po bëni politikë, kamë kërkes për juve dyve zgjidhmna problemin e transportit për Mollopolc.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Edhe një herë ai që fol jasht pikës do ti ndërprehet fjala, ju lus të flisni për KAB-in.

znj.Rrezartë Ramadani: Kelegut të par që foli prej Vetëvendosjes arsye, a pse i kamë bojkotuar dëgjimet publike ka qenë pikërisht kjo, sepse projektet që i kamë propozuar unë vitin e kaluar asnjana nuk është bërë, dhe kjo ka qenë arsyeja. Gjithashtu nuk është e thanun vetëm në dëgjime publike me i paraqitur kërkesat e qytetarëve, projektet që kanë interes, se bashkëbisedimi me qytetarë nuk përfudnon veç qat ditë dhe as nuk bahet veç qat dit por bahet ndërkoh, ki plot qytetar që nuk munden me marrë pjesë edhe ndërkoh të shkruajnë se e din që je përfaqësuesi i tyre. E dyta kolegut tjetër i them se këto projekte që unë i bana është dashur me i përsëritur edhe këtë vit, spese kanë qenë kërkesa edhe qysh vitin e kaluar dhe nuk është bërë asgjë. Kur e mora fjalën unë thash që keni kohë deri në gusht mandej ju fillut me thanë jo politik.

znj.Zejniye Veliu: Ne këtu sot jemi të thirrur me rendin e ditës për KAB-in, kështu që gjitha diskutimet duhet të jenë të orjentuara në KAB e jo në interpretime, ngatrresa personale, tash e di që është edhe vit zgjedhor edhe shumica prej neve edhe kemi me qenë edhe në lista, mirëpo mos ta shfrytzojmë ne sot foltoren e Kuvendit për me marr një votë ma shumë. Qytetari e don projektin, qytetari e don realizimin e projektit, kështu që tu kisha lut Kryesues që të vazhdojna mos të shkojna në personale.

z.Besnik Seferi: Du me ju kërkuar gjith qytetarve të komunës së Shtimes për naj gaf që mundemi me bërë. Mue po më vjen mirë që opozita e ka atë dert për koalicionin tonë që jemi mosmirnjohës, nuk asht e vërtet kemi mirënjohje gjithë herë në raport me koalicionin që kemi. Këtu po bisedojmë në emër të grupit politik dhe jo asnjher mos të mirren individuale këto çka po diskutojmë këtu. Ne si grup palamentar deklarohemi se jemi pro këtij Drafti të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026 -2028 dhe urojë dhe shpresoj shumë që edhe nga kolegët të mbështesin këtë draft.

z.Rexhep Gashi: Është ka bahet fushat dhe i rri prapa asaj çka kamë thënë, është momenti i fundit i koalicionit, por mbi të gjitha e ka pas. Fushat është bërë edhe ma herët nga asambleistet e VV ku në mbledhjen e fundit i kanë dhez motorrat ,projekte premtime tu ju ba. Unë mendoj se profa Muahmet ka qenë njeri i dyt i Petrovës qe 24 vjet edhe ende ska ujë të pishëm shkollën e Petrovës, edhe për neve është shqetsuese unë e kam trajtuar se është një lluks kur skan nxansat ujë, profa Muhamet por tash ai duhet vet ta arsyeton pse ska reflektuar ma herët për arsye personale. Koalicionin e kanë bërë me parime të shnoha. Projektet a jan marr se di, por tre qytetarve jo projekte individuale, aty u dasht mu prek, u dashtë gjitha projektet me i lanë me zgjedh procesin e kanalizimit edhe trapsortit, mbi gjitha ato janë lluks. Pak ashtu tu ba popullizem asambleistët e pozites, ju keni kërkuar të specifikohet, pse nuk keni intervenuar këtu, me thanë na kemi kërkuar të specifikohet, pse spo na ndodh këtu specifokoni rrugët. Buxheti është i qytetarëve se ke ngrit shqetismim më herët e ke ngrit vetëm në momentin e fundit me bërë popullizem. Nëse nalet

korigjohet mbi të gjitha që ke nga shtat projekte me dhjet mijë euro duhet të korigjohen, nëse kalon ky draft, kështu nuk kemi hapsirë me kalu.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ: Përshëndetje. Po du me u ndërlidh në disa pjesë në disa diskutime: E para po du me u ndërlidh me këtë pjesën e koalicionit se disa njerëz këtu po na lujnë rolin e Avokatit, ne jemi mirë ka kërkesa të koalicionit që janë të arsyeshme dhe për të cilat diskutojmë për secilin prej asambleistëve nuk ka nevojë këtu ju me naj luftë avokatin këtu, se a jena mirë me koalicion a jo, sepse nuk i doni ma shumë se na, se e ka dëshmuar historia se nuk i doni ma shumë se na as LDK-në as profen Muhamet. Sa i përket Rrezes kërkesë për ndriçim te lagja Neziraj e ki në kolonën 49, sa i përket rrugës “Komandat Kumanova” një segment që e përmende të lutna veç vjen edhe e specifikon me dit cili segment është edhe a ka ardhur kërkesa, sa i përket organizatave bugetore që e ke pas kërkesën në fillim që thave është vlerë e madhe ne kemi obligime bugetore sa i përket këti kodi tu fillu prej ndërtimit të shkollave Çerdheve, Objektivit të Komunës që kemi memorandume të nënshkrime, nuk mund të futet secili memorandum në këtë kod, që don mi pa dikush obligimet e komunës për memorandumet kur dush mundemi me ti prezantuar. Sa i përket buxhetit, specifikimit të buxhetit Rexhep veç lidhe cili projekt kapital nuk është i specifikuar për veç Dugës dhe Karaqicës që nuk ka emërtime te sakta gjitha projektet tjera janë të specifikume. Lidhur me projektin 5 mijë euro është e vërtet që vlera 5 mijë euro është e vogël, mirëpo kemi projekte të pa fillume të vitit 2025 për të cilat nuk dihet vlera sakt sa mund të jetë kontrata, në momentin që kontrata tyre është ma e lirë këto mjete kalojnë në buxhetin e vitit 2026. Se sa kemi bërë edhe sa jemi tu bërë veç jepja një qark rreth Shtimes dhe rreth fshatrave e sheh. U përmend Rashinca dhe Muzeqina mundem me thënë me krenari që Rashinca ka park, ka shteg të ecjes, po rregullohet shtrati i lumit të gjitha janë duke u rregulluar. Në këtë moment Muzeqina ka Çerdhe të funksionalizume, po rregullohet shtrati i lumit, është përfunduar ndriçimi, nuk ka asnjë rrugicë të pa shtrume në fshatin Muzeqinë, trotuari deri në Vojnoc që e përfshin edhe Muzeqinën është i përfunduar. Ato qytetarët i shohin nuk më intereson a i shef ti ato a jo, edhe një argument tjetër dil në Petrovë ka shpia jote karshi shpies tane Adelinë e ki një projekt, një rrugë anë rruga “Mehdi Korrani” 500 mijë euro dhe tjetrën anë një projekt e ki, rregullimin e shtratit të lumit që tashmë ka filluar. Më vjen keq që shumë këto projekte nuk kanë marrë përkrahje prej juve, ma shumë keni qenë pengesë sesa keni kryer punë. Kështu që për krejt këto që u përmendën sot qytetari po i shef nuk është me rëndësi a i shef ti a jo.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Unë po i japi disa sqarime sa i përket vetëm çështjes së financave në këtë Draft Kornizë. Në buxhet futen projektet një vjeçare dy vjeçare, mund të jenë edhe tri vjeçare, ato çka e kanë një kod jemi të obliguar çka kan qenë projekte dy vjeçare e kemi obligim shumë e ati buxheti të mbetur me shti në buxhet, keni thënë edhe vitin e kaluar që kanë qenë 19 projekte me vlera te vogla e kurrë skam me mabru edhe skeni mi shti por gjitha janë kryer. Sa i përket fshatit Gjyrokoc në dëgjime publike për të cilin ka qenë asambleisti Rexha edhe Rexha është betu publikisht se do ta votoj buxhetin nëse hyn dislokimi i fushës. Për vec fushës pi permeni vetëm dy projekte që kanë hyrë në Gjyrokoc ka hy edhe kulmi, pra këtë bakshish që shan kry këto punë e kanë pas banorët nga Rexha që se ka aprovuar buxhetin e vitit 2025. Kolona 14 shumat e vlerave janë 10 mijë mbarojnë me vlera të mëdha fillojnë këtë vit edhe mbarojnë në vitin 2026. Ky është draft mund të ulemi bashkarisht nëse e shohim që mund të hyjnë projekte do dakordohemi bashkë ju ftoj ka nja ka nja në zyre, ulemi i shohim gjitha kërkesat edhe besoj kena me u dakorduar që ky draft me u bërë në mënyrën më të mirë të mundshme.

z.Rexhep Gashi: Drejtor i financave a e kam kaluar buxhetin edhe pse se kam kaluar buxhetin unë arsyen e kamë dhënë muj me ta dhënë edhe këtu sot, ndëgjjo nuk muj me ta kalu ty buxhetin kur i ki 11 projekte me 5 mijë euro, në qoftëse u ba dislokimi i fushës nuk ka ndodh edhe ska me ndodh kurrë, nuk mundesh me realizuar. Drejtorit të Urbanizmit ndërtimi i urave në Godanc, Zborc dhe Pjetershticë 50 mijë euro e ki kolonën 13. E ki rregullimi i rrugëve bujqësore me zhavor në fshatin Muzeqinë, Godanc, Zborc, Petrovë, Vojnoc, Gjyrokoc në Shtime me 5 mijë euro kolonë 7, në qoftëse i ki te specifikune në cilat rrugë urdhëro. Asfaltimi i disa segmenteve të rrugve ndriçimi në fshatin Pejtërshticë, nëse e ki te specifikune cilat rrugë urdhëro. Asfaltimi i rrugës rregullimi ndriçimit dhe trotuarit në Gjyrokoc specifikojë cilin trotuar, kolona 44. Rregullimi i trotuarve dhe ndriçimit si dhe asfaltimi i rrugve në Rashincë, nuk ki specifikim, rregullimi i rrugëve dhe

trotuarve në Vojnoc kanalet kulluse ndriçimi nuk e ki të specifikune, rregullimi i segmenteve të rrugve ndriçim, kanalizim Carralevë, asfaltimi i dy rrugve, kanalizimi në Lagjen, ku janë të specifikune, rregullimi i segemneteve të rrugve ndriçim dhe kanalizim në Dugë edhe vet e përmende edhe ky fshat na ka mbet keq që nuk është në digjitalizim të rrugve.

z.Adelina Beqaj: Sa i përket përgjigjeve të drejtorit të Urbanizmit, kështu drejtor në fshatin Muzeqinë dhe në fshatin Rashincë i përmende projektet që kanë kaluar. Pyetja ime direkte ke çka ke planifikuar për veç një rrugë lidhëse asgjë tjetër dmth. qyky është planifikimi yt si drejtori dhe ekzekutivi të komunës. Sa i përket qatë ku ma paske mësuar edhe Shtëpin ku e kam se me qëllim keni shkuar ju aty me pastru lumin aty se mos mendo se është duke u bërë për herë të paër pastrimi i lumit aty. Pjesa, kamë kërkes direkte personale, sepse ajo rrugë ka nevojë edhe për me u shtru asfaltit rishtazi, ka nevoj për ndriçim, po nuk po dua me personalizuar aq shumë këtë që mos me qenë lokaliste. Pyetja ke edhe për fshatin Petrovë trotuari që është në fillim të fshatit rrugën kryesore është i pa mirmbajtur. Pjesës së investimeve në rrugën “Mehdi Korrani” që gjashtë muaj a shtatë jeni duke shkuar në atë rrugë. Nuk është që keni bërë projekte të mdhaja në ata fshat që ka edhe kompani që bajnë prodhim që e meritojnë paguajnë taksa këtu në komunë njera prej tyre është edhe prindi jem që vjen pagun tatime këtu në komunë edhe nuk është që e ka lagjen për mashallah aty. Ka nevoj për rrugë ka nevoj për trotuare ka nevoj tër fshati Petrovë, i keni bërë politike grahini edhe nja 3 katër muaj ju kanë mbetë grahni pa kurfar problemi. Kështu që mos u mundo me personalizizim pjesën politike me mue se janë kërkesa që kanë të bëjnë me krejt fshatrat e jo me mue.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Sa i përket emërimit të projekteve që thuhet kanë munges të emërimit të rrugve, po foli për projektet e viti të kaluar nga gjitha projektet që kan qenë në qet draft kan kaluar gjitha, edhe në Ministri qysh janë futur në program kanë mbet, nuk kemi pasur asnjë rekomandim që të ndryshohet, po të kisha pas naj presje se leje ma munges, ata janë profesionist ata s’kishin kaluar edhe kishim marrë rekomandim për me hy me i ndryshuar, unë e di që ka këtu edhe drejtor edhe e dinë mirë qysh funksionon ai program. Nuk mundesh aty mi shkruar 500 shkronja por e ka një kufizim që e përcakton të sakt numrin e shkronjave, nuk ta lejon programi me ba me shkru tepër shkronja.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ: Sa për rikujtim Adelina, nuk po pastrohet shtrati i lumit, por po rregullohet shtrati lumit prej Luzhakve deri te Robojtë do të futet në pjesë të betonit në formë të trapezit, kështu që të jeshë ma e qartë nuk ka pastrim por ka rregullim të shtratit të lumit që një herë e përgjithmon Petrova do ta ketë lumin e pastërt dhe nuk ka ma nevoj me pastruar çdo vjetë.

z.Lumni Amrush: Përsëritet. Edhe tash një vit në këtë far faze kemi qenë një rrugë në fshatin Pjetërshticë, nuk egziston me atë emër dhe ju kamë thënë që keni kohë me përmirsuar edhe në fazën e dytë Gusht Shtator, ka kalu edhe në buxhet në Shtator me qat emër. Programi PIP sta kthen ama qajo rrugë nuk egziston as në kadastër as nuk u shtrua veç si emër egziston në buxhetin e juaj, për çudi këtë vit e keni bërë edhe një gabim të njejtë për dallim me vitin e kaluar, nuk po propozojë sepse e di që nuk bahet ajo punë. Edhe po thirrreni shumë në degjim publik qysh me shti rrugen Lumni Amrush mundeni me gjet qat rrugë me matë qatë rrugë edhe me shti në buxhet. Taman është buxhet i fushatës, jena gjashtë muajt e fundit edhe me i ni do këtu që thojnë mos bënë politikë, ja qitash duhet me bërë politikë ja kurr. Jeni dal nëpër krejt diskutimet publike i madh e i vogël edhe dej Kryetarin e keni marrë në këto dëgjime publike edhe keni bërë politik, jo që keni fol për KAB-in aty po i keni menagjuar mirë masen aty i keni mashtruar mirë, më vjen keq prej qytetarëve po qashtu po shihet, keni folë për projekte që janë bërë e skan të bëjnë hiç me atë vendbanim, keni marrë 20 kërkesa 30 kërkesa sot asnjë kërkesë nuk ka hyrë këtu në buxhet. Veç dallomi 3 ose 4 kërkesa që dallojn prej draftit para një muaji edhe tash me emër thuaj, drafti ka qenë 20 i kemi ulë i kemi bërë 25 asnjë nuk u bërë, asnjë nuk u ndryshuar, kjo asht politika që po bëni ju, shumë projekte qaq sa skeni kqyr as kur. A më tregon cilin park e ke ndërtuar një park mem qu te qaj park që e ke ndërtuar qe tri vjet në Pejtërshticë, i keni marr emrat edhe i keni lanë dikun nëpër lista. Jo që po bëni politik edhe dokumentin jeni tu e bërë për politikë, prandaj mos të flasim këtu në personale se shihet qytetari ju shef ju dëgjon edhe punët janë pa, edhe mospuna

u pa, edhe diskriminimi u pa, jemi komunë e vogël e njofmi njëri tjetrin. Te pjesa e specifikimeve mos i lejo drejtor shumë se tani ti japin me listë çka nuk janë të specifikume.

z.Reshat Mujota: Pyetje kamë për drejtorin e financave, drejtor na u drejtove shumicës që nuk e kena kuptuar draftin buxhetor që janë projektet dy vjeçare. Kamë pyetje konkrete pasi e ki lllpatopin përpara mundesh me hy ndër vite, shikoje kornizën afatmesme 2022 – 2024 , shikoje kornizën 2023 – 2026 po flas për projektet e njeta dy vjeçare, nëqoftëse ka pas kërkesë në kornizën e vitit 2022 -2023 ose 2024 u duft me u përfunduar projekti nëse u kan projekti dy vjeçar. Unë fola për projekte sidmos për fshatin Mollopolc të cilat janë bartur nga viti në vit qe tri vite e gjysëm po bahen janë bartë këto projekte. Unë që nga viti 2021, 2022, 2023 e 2024 deri në vitin 2025 të njejtat kërkesa i kamë për Mollopolc, nuk e mohoj që nuk u rregullu diçka tjetër, por kërkesat e qytetarëve që kanë qenë edhe shtrati i lumit nuk janë realizuar, po presim me u realizuar jam tu kërkuar për pjesën e kërkesave që e përfshin gjith fshatin, kanalizimi te kulla ka qenë edhe vitin e kaluar a mun mema sçaru dy vjeqaret projektet kur duhet me u kry a pas këtër viteve a kur. Pse unë i kam të njejtat kërkesa prej vendit nga vijë unë, se nuk janë punuar, nëse ishin punuar kish dal një kërkesë tjetër.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Ka disa projekte që gjithë jemi dëshmitar përmbaruesit ju marrin te investimet kapitale edhe mundemi me pas mos realizim të projekti të caktuar, ka projekt që e ka marr buxhetin thesari i shtetit për një projekt që u kanë i buxhetun edhe ska mundur me u realizuar.

z.Reshat Mujota: Mu ka premtuar qitu, punimet me zhavor nëpër ara, tash as në draft nuk e ki atë punë që ka me u ba as nuk u ba, pikërisht mu ka thënë qitu prej drejtorit Kastriotit kur ka qenë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Atëherë po e hudhim në votim Draft Konizën Afatmesme Buxhetore 2026 – 2028 pas diskutimit publik. Du me i falënderuar gjithë kolegët asambleist për diskutimet që i paten. E tha edhe drejtori po e them edhe unë që kjo Kornizë Afatmesme Buxhetore do të mbrohen kufijtë në thesarin e shtetit, pastaj do të rikthehet prap në dëgjim publik dhe do të votohet në muajin Shtator. Ju e dini që mundet të ketë ndryshime prap kërkoj nga gjith ju që kët draft edhe ather kur janë dëgjimet publike edhe ato që i tha profa Muhamet edhe Rexha mos ti përmendi gjithëve emrat, zotri Gashi e zotri Mujota e zonja Beqa. Të mbledhemi bashkë në muajin Gusht kur kthehet Korniza prej thesarit të shihet dhe ne bashkarishtë të shohim se çka mundemi me ndryshuar. Kërkoj ta kalojmë këtë pikë të rendit të ditës.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 9 vota “Për” (Duke përdor Kryesuesi votën e dyfisht sipas nenit 48.1 Ligjit Nr.03/L-040 të LVL-së), me 8 vota “Kundër”, dhe me 0 vota “Abstënim”, miratoi Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore Komonale 2026-2028.**

Pika 3

Pyetje – Përgjigje

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Rrahman Jakupi: Unë kamë pyetje edhe komente, është shqetësuese fakti që pothuajse tërë mandatin unë kamë parashtruar kërkesa për qasje në dokumenta publike dhe është qudi qfarë administrate e pa përgjegjëshme është në dhënjen e dokumentave ndaj anëtarëve të Kuvendit përkatësisht neve si zyrtar që jemi, është shqetësues fakti që ne barazohemi, ne vijojmë këtu ç’do seancë çdo mbledhje ngriten dokumentacione dhe nuk na jepen. Gjithmonë shikohet qysh me ju ikë përgjigjeve që na takojnë me ligj. Unë nuk jamë këtu për me arsyetuar asnjë prej zyrtarëve komunal, mirëpo nga pjesa politike duke përfshir këtu Kryetarin i cili është zyrtari kryesor administrativ i cili është i pa përgjegjshëm, mandej detyrohet nga Agjensioni për privatësi që me na i dhënë këto dokumente.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Nuk ke nevoj me ofenduar askënd drejtoje pyetjen, kaq.

z.Rrahman Jakupi: Kamë shumë pyetje është pse nuk i kamë pranuar pyetjet që i kamë parashtruar në mbledhjen e kaluar, pyetje është pse administrata komunale në këte rast Kryetari i Komunës nuk përgjigjet në pyetjet që une i përcjelli si anëtar i Kuvendit, pyetjet pastaj përfshijnë edhe lidhur me disa pyetje që kanë qenë për disa vepra penale që kanë ndodh në drejtorin e Shendetësisë në Drejtorin e Planifikimit Urban Kadastër dhe Gjeodezi, në Drejtorin për Kulturë,

mirëpo në veçanti ishte ajo e Drejtorisë së Shëndetësisë. Pyetja tjetër është a pagun Drejtoria për Administratë përkatësisht Zyrja e Kryetarit njerëz të cilët në mënyr të kundërligjshme punojnë nga organizata jo qeveritare në mënyr të kundërligjshme AZHR, e cila është duke u hetuar si vepër penale, dikush e ka përshtypjen që ato kanë mbaruar, mirëpo për fat të mirë nuk kanë mbaruar janë duke vazhduar ende, dhe ata zyrtar komunal na inçizojnë neve këtu përmes shades së Kabinetit të Kryetarit e mundohen me na i fokusuar fëtyrat që pastaj në rrjetet sociale me përmbajtje fake të cilat besoj shumë shpejt do të zbulohen dhe do të publikohen. Në këtë rast shefja e kabinetit i kërkon zyrtarit komunal që të na fokusoj fëtyrat dhe pastaj plasohen në rrjetet sociale fake, të cilat vet Kryetari i Komunës është ankuar për to e pastaj del që ai vet i menagjon ato, i njeiti fake portal në vitin 2021 ka bërë lajme të rrejshme, kundra meje personalisht pas pranimit të dokumentacionit përkatës unë do të ngris kallxim penal për atë person, mirëpo penges është Kryetari i Komunës i cili i ndalon dokumentacionet. Pyetje tjetër për Kryetarin e Komunës sa projekte janë duke u hetuar nga njësia për hetimin e krimit dhe korrupsionit në Komunën e Shtimes, në cilat drejtori janë ato. Pyetje tjetër është pse ju si administratë komunale nuk i keni lënë anëtarët e Kuvendit që të debatojnë lidhur me projektin e ujit në fshatin Rashincë. Pyetje tjetër është disa herë me radhë në mbledhjet e Kuvendit të Komunës kamë kërkuar qasje në dokumente publike në formë verbale si sot që po e bëjë dhe nuk kamë pranuar përgjigje, kjo duhet të evidentohet në procesverbal për arsye të dorëzimit të kërkesës në Agjensin për privatësi. Po ashtu përsëris pyetjet nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të cilat përgjigje nuk i kamë pranuar nga administrata komunale.

znj. Adelina Beqaj: Pata propozime konkrete për shkollen në fshatin Belinc po nuk mora përgjigje nga drejtori po besoj që ka marr shënime dhe do të reflektojë. Sa i përket përmbaruesit Kryesues që the, përmbaruesi 2023 e 2024 ka fillu me i marrë mjetet në Komunën tonë, por projektet i ki prej 2021 që ende nuk janë përfunduar, po e bajë pyetjen e Reshatit sa është periudha e kti dy vjeçari sipas juve se përnime dy vjet po hecin po prap po jet projekti dy vjeçar. Drejtoresha e Shëndetësisë pse nuk e ke bërë planifikimin në QPS nuk kishe planifikime rreth QPS-së edhe pse është institucion shumë i rëndësishëm. Më kujtohet në fillim të mandatit kur paten ardhur këta kolegët tu asambleist në ekzekutiv paten ardhur me atë ritmin qysh është e mujshme me punu dikush me Caritas pa i përfillur procedurat për rekrutim, e ju e keni mush QPS dhe QKMF me Caritas që nuk është ka dihet kush është punëtor social e kush është praktikant e kush është ndihmës punëtor, qaq është banalizuar kjo pjesë sa që nuk po mundem me kuptuar qysh ju i keni shti ashtu që jeni thirrë në atë pjesë. Edhe pjesa tjetër nashta ktu mundet me më dhënë përgjigje Kryetari ose Drejtoria e Ekonomisë çka është ka ndodhë me tregun prej që ja keni nis me marrë mandatin e keni nisë qatë treg e hala të premten tregtarët po shesin sendet në trotuar, po e kryejn tregtin e tyre të asaj pjese, qe 4 vjet në fakt u kry ma mandati juaj, hala nuk keni mundur me funksionalizuar tregun në Komunën e Shtimes.

z. Reshat Mujota: Po i baj pyetjet e njeita të mbledhjes së kaluar, kamë pyetur për juve Kryesues çka po ndodh me vendimin qe u marrë para një viti për Komisionin për ndarjen e qmimit “Sakrifica e Reçakut”, ky Komision asnjëherë nuk u thirrë me u funksionalizuar dhe puna nuk ka vazhduar se ju si Kryesues asnjëherë nuk e keni ftuar. Pyetje e dyt është e njejtë për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Kryesive të fshatrave dhe lagjeve, pse kaloj një mandat sepse u fol edhe te drafti, po të kishte qenë një Kryesi e zgjedhur nëpër lagje nëpër fshatra edhe projektet do të ishin shumë ma unanime dhe shumë ma konkrete, kjo spo ndodhë a po ju konvenon kjo mos me u zgjedh edhe me punuar me individ apo ku është arsyeja tjetër. Dhe pyetje e tretë ka qenë kur kamë pyet bashkpunimin me OVL të UÇK-së si qëndrojnë punët, ndërsa e kamë marrë përgjigjen që janë dakorduar në secilin manifestim, po më del që po ka ndarje institucionale, dhe pse asht tu ndodh kjo ja parashtroj prap drejtoreshës. Si pyetje e fundit është për Komisionin për Emërimin e Institucioneve Publike, shkoj mandati asnjë raport i këti Komisioni nuk ju drejtua Kuvendit, kisha kërkuar që në mbledhjen e radhes o nga Kryesuesi të vijë të na raportoj deri ku ka shkuar ky proces, dhe pse nuk vinë kërkesat në Kuvend, pse nuk ka vazhduar emërimi i këtyre Institucioneve Publike. Kisha pas qef ju si Kryesues edhe ai si Kryesues i Komisionit ta hudhni si pikë të rendit të ditës në mbledhjen e ardhshme ku kemi anëtar prezent që janë në atë Komision munden me dhënë sqarime.


znj.Rrezartë Ramadani: Pyetja ime është për Kryetarin Aliu pse unë si anëtare e Komisionit për ndarjen e titullit “Nderi i Qytetit” kur vjen koha me i nda këto tituj ne asnjëher nuk ftohemi dhe as nuk paralajmërohem që këto çmime po ndahen, pse po ndodhë ky mosrespekt ndaj punës së Komisionit.

z.Besnik Seferi: Unë i kamë dy pyetje e para është në rrugën “Viliam Voker” aty është duke u punuar drejtor duke u rregulluar çështja e disa disa gropave ku hapja e atyre gropave gjat punimeve po janë kogja të rrezikshme, kërkoj që kompanisë ti ipet një vërejtje së paku, aty ku punohet normalisation duhet me u gropuar, por pastaj të paktën mos të lihen gropat hapur, sidomos në mbramje pasi të përfundojë puna pasi që po është rrezik për qytetarët. Pyetja e dytë, e di që shtyllat elektrike kanë të bëjnë me KEDS-in por kamë një shqetësim të kahershëm te një familje në fshatin Belinc te familja e Sinanve ku është një shtyllë pothuajse gati e rrëzume kejt, për çka është tu e rrezikuar jashtëzakonisht atë familje, kërkoj nga Drejtoria e Shërbimeve Publike që ta bëjë një vërejtje te KEDS-i.

z.Lumni Amrushi: Kamë disa pyetje, disa që përsëriten vit pas viti e që nuk po realizohen disa punime, po flas për fshatin Pjetërshticë i kamë ngritë këto pyetje disa herë këtu por shumicën e herave nuk kamë marrë as përgjigje, po nuk janë kryer as punët atje. Në këtë mandat nuk është punuar asnjëherë në onorin e shkollës i cili ka nevojë urgjente për intervenim. Ka mbet edhe një hapsirë mes ambulancës dhe shkollës bosh që pothuajse nuk është trajtuar që dy vite e që fëmijët kanë nevojë shumë për hapsirë dhe gjelbrim. Ka mbet shkolla e vjetër pa u rrënuar e që kanë nevojë shumë për një fushë të jashtme, është rrethoja shumë e demolime, te shkolla duhet të ketë trotuar për shkak se fëmijët dalin direkt në rrugë. E këto pyetje kanë qenë që tre vite pothuajse duke u përsëritë por ende nuk është bërë asgjë në këtë pjesë, të paktën një përgjigje se a do të bahen najherë. Mandej ka mbet Kazerma prej mandatit kalun punët finale pa u përfunduar edhe kemi prit shumë që ka me u përfunduar, mirëpo shkon mandati nuk u përfundua, tani ka fillu edhe me u dëmtuar edhe ato investime për shkak se nuk është përfunduar me kohë dhe për deri sa nuk ka mirëmbajtje do të dëmtohen edhe ato punime që kanë ndodh në të kaluarën. Është premtuar shumë një park gjatë fushatës te shkronjat te monumenti i tri shkronjave të arta të UÇK-së në fshatin Pjetërshticë e i cili është monumenti i parë në trojet shqiptare i ati formati e pas tij kanë ndodh edhe dhjetra tjera nëpër Kosovë e aty nuk është investuar, është shkuar një rrugë por as deri aty ku është premtuar edhe ku është dashtur me shkuar ka mbet në gjysëm. Disa herë kemi kërkuar që të bahet edhe pastrimi Lumit dhe me një pjesë të bahet edhe investim aty së paku para kazermes. Kemi kërkuar disa herë që të bahet rregullimi i rrugëve të dëmtuara për shkak të punimeve që kanë ndodhur gjatë viteve në fshat, ka shumë vende ku është rruga e preme për shkak të lidhjes në kanalizim por nuk është renovuar asnjëher. Madje rruga “Idriz Ajeti” ka mbetë pa u renovuar prej shkollës e deri në fund të fshatit. Ke plot rrugica që janë demoluara brenda fshatit, mirëpo nuk është intervenuar asnjëherë në atë pjesë. Janë këto që asnjëher nuk kam marrë përgjigje konkrete por edhe nuk janë kryer këto projekte.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Pasi që diskutime të tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora: 10:32h.

Procesmbajtësi
Sami Januzi



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi

